



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 141

23 gusht

2013

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr. 645, datë 31.7.2013	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Kashar të qarkut të Tiranës..... 6095
Vendim i KM nr. 646, datë 31.7.2013	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Fierzë, Pukë të qarkut të Shkodrës..... 6096
Vendim i KM nr. 647, datë 31.7.2013	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Sinaballaj të qarkut të Tiranës..... 6097
Vendim i KM nr. 648, datë 31.7.2013	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Qelëz të qarkut të Shkodrës..... 6098
Vendim i KM nr. 649, datë 31.7.2013	Për një shtesë në vendimin nr. 478, datë 30.5.2013 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Pezë të qarkut të Tiranës”..... 6099
Vendim i KM nr. 651, datë 16.8.2013	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Brendshme, të pasurisë së paluajtshme “Shtëpia Qendrore e Ushtrisë”, me qëllim pajisjen e subjektit Partia Demokratike e Shqipërisë me ndërtesë, për seli qendrore..... 6099
Udhëzim i MPPT nr. 4, datë 2.8.2013	Për miratimin e tarifave të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre..... 6102
Udhëzim i MASH nr. 21, datë 2.8.2013	Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për dhënien e medaljes së artë..... 6104
Udhëzim i MASH nr. 23, datë 2.8.2013	Për ndjekjen e gjimnazit me kohë të pjesshme..... 6105

Udhëzim i MASH nr. 24, datë 2.8.2013	Për certifikimin e hartuesve të testeve dhe vlerësuesve në provimet kombëtare.....	6107
Udhëzim i MASH nr. 25, datë 2.8.2013	Për organizimin dhe funksionimin e qeverisë së nxënësve.....	6108
Udhëzim i MASH nr. 26, datë 2.8.2013	Për përcaktimin e detyrave dhe funksioneve të këshillit të mësuesve....	6111
Udhëzim i MASH nr. 27, datë 2.8.2013	Për bordin e institucionit arsimor.....	6113
Udhëzim i MASH nr. 29, datë 2.8.2013	Për procedurat e ndjekjes së arsimit bazë me kohë të pjesshme.....	6116
Udhëzim i MASH nr. 30, datë 2.8.2013	Për rregulloren tip të institucioneve arsimore.....	6118
Udhëzim i MASH nr. 31, datë 2.8.2013	Për procedurat e ndjekjes së arsimit bazë për nxënësit që nuk kanë ndjekur të paktën dy klasa të arsimit bazë.....	6119
Udhëzim i MASH nr. 34, datë 2.8.2013	Për planifikimin e fondeve buxhetore dhe ndjekjen e procedurave të prokurimit për blerjen e librave të bibliotekave të institucioneve arsimore publike.....	6121
Udhëzim i MASH nr. 36, datë 13.8.2013	Për procedurat për arsimimin e fëmijëve të ngjuar.....	6122
Udhëzim i MASH nr. 37, datë 13.8.2013	Për kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve të këshillit vendor të arsimit parauniversitar.....	6123
Udhëzim i MASH nr. 38, datë 13.8.2013	Për arsimimin e individëve të moshës shkollore në institucionet e përkujdesjes shoqërore.....	6124
Udhëzim i MPÇSSHB nr. 5, datë 7.8.2013	Mbi zbatimin e vendimit nr. 31, datë 20.1.2001 të Këshillit të Ministrave “Për përfitimet nga statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar.....	6125
Udhëzim i MPÇSSHB nr. 6, datë 7.8.2013	Mbi zbatimin e vendimit nr. 618, datë 7.9.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”, të ndryshuar.....	6126
Udhëzim i MPÇSSHB nr. 7, datë 7.8.2013	Mbi zbatimin e vendimit nr. 277, datë 18.6.1997 të Këshillit të Ministrave “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, të ndryshuar.....	6126
Udhëzim i MB nr. 425, datë 9.8.2013	Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet e pjesshme të parakohshme për kryetar të komunës Dardhas dhe Rrethina.....	6127
Udhëzim i MF, MSH nr. 446, datë 12.8.2013	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 2, datë 15.1.2013 “Mbi procedurat e prodhimit, kodimit, stampimit, shpërndarjes dhe monitorimit të pullave të kontrollit të barnave”.....	6131

VENDIM
Nr. 645, datë 31.7.2013**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS KASHAR TË QARKUT TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Kashar të qarkut të Tiranës, sipas lidhjes nr. 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Kashar të qarkut të Tiranës, miratuar me vendimin nr. 1469, datë 5.11.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Kashar të qarkut të Tiranës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Kashar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Kashar

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-4	Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën administrative	Në pronësi
5-13	Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën arsimore	Në pronësi
14	Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën kulturore e sportive	Në pronësi
15-21	Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
24-31	Varrezat publike	Në pronësi
32-37	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
38-66	Infrastrukturë (rrugë vendore, sheshe, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
73-81	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi
150-153	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim



VENDIM
Nr. 646, datë 31.7.2013

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS FIERZË, PUKË TË QARKUT TË SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Fierzë, Pukë të qarkut të Shkodrës, sipas lidhjes nr. 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Fierzë, Pukë të qarkut të Shkodrës, miratuar me vendimin nr. 878, datë 12.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Fierzë, Pukë të qarkut të Shkodrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Fierzë, Pukë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Fierzë, Pukë

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
2-10	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
15-18	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
19-26	Varrezat publike	Në pronësi
459-470	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
474-481	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi

VENDIM
Nr. 647, datë 31.7.2013**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
KOMUNËS SINABALLAJ TË QARKUT TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Sinaballaj të qarkut të Tiranës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 40 (dyzet) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 256 (dyqind e pesëdhjetë e gjashtë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Sinaballaj për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Sinaballaj

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-7	Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën arsimore	Në pronësi
8-10	Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
11-24	Varrezat publike	Në pronësi
25-37	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
38-45	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi
170-171, 174-198	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
201, 204	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi



VENDIM
Nr. 648, datë 31.7.2013

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
KOMUNËS QELËZ TË QARKUT TË SHKODRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Qelëz të qarkut të Shkodrës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 89 (tetëdhjetë e nëntë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 621 (gjashtëqind e njëzet e një).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Qelëz për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Qelëz

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
554	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
555-561, 621	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
562, 563	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
564-575	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
576-585	Varrezat publike	Në pronësi
586-592	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi
604-618	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
620	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi

VENDIM
Nr. 649, datë 31.7.2013

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 478, DATË 30.5.2013 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË
PËRDORIM TË KOMUNËS PEZË TË QARKUT TË TIRANËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në lidhjen, që i bashkëlidhet vendimit nr. 478, datë 30.5.2013 të Këshillit të Ministrave, shtohen pronat me numrat rendorë 34 - 128 (tridhjetë e katër - njëqind e njëzet e tetë) dhe 160-171 (njëqind e gjashtëdhjetë - njëqind e shtatëdhjetë e një), sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Pezë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Pezë

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
34-128, 160-171	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi

VENDIM
Nr. 651, datë 16.8.2013

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TË
MINISTRIA E BRENDSHME, TË PASURISË SË PALUAJTSHME “SHTËPIA QENDRORE
E USHTRISË”, ME QËLLIM PAJISJEN E SUBJEKTIT PARTIA DEMOKRATIKE E
SHQIPËRISË ME NDËRTESE, PËR SELI QENDRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 22 shkronja “b” e 22/1 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për parti të politike”, të ndryshuar, dhe të neneve 8 pika 3, 13 e 16 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Brendshme, të pasurisë së paluajtshme, të konfirmuar nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, me emërtimin “Shtëpia Qendrore e Ushtrisë”, me numër rendor 32, përkatësisht sipas formularit që i bashkëlidhet këtij vendimi, miratuar me vendimin nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar”.

2. Prona e përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

3. Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Brendshme, brenda datës 20.8.2013, të përfundojnë procedurat e marrjes në dorëzim të pronës.

4. Ministri i Brendshëm të lidhë kontratën e huapërdorjes, sipas Kodit Civil, me subjektin politik Partia Demokratike e Shqipërisë.

5. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Mbrojtjes dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE/
(Per Inventarizimin e pronave te vecanta)

A				B			C			
Nr	Zona Kadast. Indeksi i hartes	Numeri Pasuris	Lloji i prones	Emertimi i prones Adresa	Siperfaqja totale prones ne M2	Nga siperfaqja totale sa ndertime ne M2	Funksioni per te cilin perdoret prona	Enti me Pergjegjesi Administrative	Enti Perdorues Statusi Juridik i perdorimit	Te dhena te tjera shenime te Veçanta
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
32				Shtepia Qendrore Ushtrise	10060 M2	1402 M2	Per trajtimin e ushtarakeve	MM Sh.Q.U	Sh.Q.U Tirane	-
				Rr.Bulevardi," Zhan D Ark ",Tirane						
				Godina qendrore	1346	1346				2 kate
				Truproje	6	6				
				Berberana	50	50				
33				Shtepia e Ushtarakeve Tirane	2537 M2	1454 M2	Per trajtimin e ushtarakeve	MM Sh.Q.U Tirane	Shtepia Ushtarakeve Tirane	-
				Rr.Bulevardi," Zhan D Ark ",Tirane						
				Hotel, bar,restaurant	1327	1327				6 kate
				Lavanteri	127	127				
				Truall	83	-				

Ministria e Mbrojtjes

Bashkia Tirane

Fusha perdorimit te prones :
Per Mbrojtjen



UDHËZIM
Nr. 4, datë 2.8.2013

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË KONTROLLIT TEKNIK TË DETYRUESHËM TË
MJETEVE RRUGORE ME MOTOR DHE RIMORKIOVE TË TYRE**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, nenit 79 pika 9 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenit 8.2.2 të Kontratës së Koncesionit nr. 4861/2 prot., datë 3.9.2009 “Për dhënien me koncesion të shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë”, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit

UDHËZON:

1. Tarifat e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë, caktohen sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Niveli i tarifës për shërbimet është shprehur duke përfshirë TVSH-në.

2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi, ngarkohet Drejtoria e Qarkullimit dhe Sigurisë Rrugore dhe Njësia e Projektit Koncesionar në Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit.

3. Ky udhëzim hyn në fuqi në datën 6 shtator 2013 dhe botohet në Fletoren Zyrtare në numrin më të parë të radhës.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

Lidhja 1

Kodi	Përshkrimi sipas klasifikatorëve të mjetit rrugor	Tarifa në ALL (TVSH e përfshirë)
1	Motomjete	870
2	Automjete me 4+1 vende	1960
3	Automjete me mbi 4+1 vende deri në 8+1 vende	2730
4	Kamionë deri në 3.5 tonë	2950
5	Kamionë nga 3.5 deri në 7.5 tonë	2950
6	Kamionë nga 7.5 deri në 18 tonë	2950
7	Kamionë mbi 18 tonë	2950
8	Autobusë deri në 32+1 vende	2950
9	Autobusë me 32 deri 42+1 vende	2950
10	Autobusë mbi 42+1 vende	2950
11	Autobusë artikularë	2950
12	Rimorkio deri në 7 tonë	2950
13	Rimorkio mbi 7 tonë	2950
14	Mjete ndërtimi deri në 7.5 tonë	2950
15	Mjete ndërtimi nga 7.5 tonë deri në 18 tonë	2950
16	Mjete ndërtimi mbi 18 tonë	2950
17	Mjete nd/punim toke deri në 7.5 tonë	2950
18	Mjete nd/punim toke mbi 7.5 tonë	2950

19	Kamionë (gjysmëkamionë) nga 7.5 deri në 18 tonë	2950
20	Kamionë (gjysmëkamionë) mbi 18 tonë	2950
21	Rimorkio (gjysmëkamionë) mbi 7 tonë	2950
22	Rimorkio të lehta deri 750 kg	2950
31	Motomjete Ri-Testo	350
32	Automjete me 4+1 vende Ri-Testo	790
33	Automjete me mbi 4+1 vende deri në 8+1 vende Ri-Testo	1090
34	Kamionë deri në 3.5 tonë Ri-Testo	1180
35	Kamionë nga 3.5 deri në 7.5 tonë Ri-Testo	1180
36	Kamionë nga 7.5 deri në 18 tonë Ri-Testo	1180
37	Kamionë mbi 18 tonë Ri-Testo	1180
38	Autobusë deri në 32+1 vende Ri-Testo	1180
39	Autobusë me 32 deri 42+1 vende Ri-Testo	1180
40	Autobusë mbi 42+1 vende Ri-Testo	1180
41	Autobusë artikularë Ri-Testo	1180
42	Rimorkio deri në 7 tonë Ri-Testo	1180
43	Rimorkio mbi 7 tonë Ri-Testo	1180
44	Mjete ndërtimi deri në 7.5 tonë Ri-Testo	1180
45	Mjete ndërtimi nga 7.5 tonë deri në 18 tonë Ri-Testo	1180
46	Mjete ndërtimi mbi 18 tonë Ri-Testo	1180
47	Mjete nd/punim toke deri në 7.5 tonë Ri-Testo	1180
48	Mjete nd/punim toke mbi 7.5 tonë Ri-Testo	1180
49	Kamionë (gjysmëkamionë) nga 7.5 deri në 18 tonë Ri-Testo	1180
50	Kamionë (gjysmëkamionë) mbi 18 tonë Ri-Testo	1180
51	Rimorkio (gjysmërimorkio) mbi 7 tonë Ri-Testo	1180
52	Rimorkio të lehta deri 750 kg Ri-Testo	1180
61	Motomjete ritestim vizual	175
62	Automjete me 4+1 vende ritestim vizual	390
63	Automjete me mbi 4+1 vende deri në 8+1 vende ritestim vizual	550
64	Kamionë deri në 3.5 tonë ritestim vizual	590
65	Kamionë nga 3.5 deri në 7.5 tonë ritestim vizual	590
66	Kamionë nga 7.5 deri në 18 tonë ritestim vizual	590
67	Kamionë mbi 18 tonë ritestim vizual	590
68	Autobusë deri në 32+1 vende ritestim vizual	590
69	Autobusë me 32 deri 42+1 vende ritestim vizual	590
70	Autobusë mbi 42+1 vende ritestim vizual	590
71	Autobusë artikularë ritestim vizual	590
72	Rimorkio deri në 7 tonë ritestim vizual	590
73	Rimorkio mbi 7 tonë ritestim vizual	590
74	Mjete ndërtimi deri në 7.5 tonë ritestim vizual	590
75	Mjete ndërtimi nga 7.5 tonë deri në 18 tonë ritestim vizual	590
76	Mjete ndërtimi mbi 18 tonë ritestim vizual	590
77	Mjete nd/punim tokë deri në 7.5 tonë ritestim vizual	590
78	Mjete nd/punim tokë mbi 7.5 tonë ritestim vizual	590
79	Kamionë (gjysmëkamionë) nga 7.5 deri në 18 tonë ritestim vizual	590
80	Kamionë (gjysmëkamionë) mbi 18 tonë ritestim vizual	590
81	Rimorkio (gjysmërimorkio) mbi 7 tonë ritestim vizual	590



91	Motomjete Ri-Testo	440
92	Automjete me 4+1 vende Ri-Testo	980
93	Automjete me mbi 4+1 vende deri në 8+1 vende Ri-Testo	1360
94	Kamionë deri në 3.5 tonë Ri-Testo	1470
95	Kamionë nga 3.5 deri në 7.5 tonë Ri-Testo	1470
96	Kamionë nga 7.5 deri në 18 tonë Ri-Testo	1470
97	Kamionë mbi 18 tonë Ri-Testo	1470
98	Autobusë me 32 deri 42+1 vende Ri-Testo	1470
99	Autobusë deri në 32+1 vende Ri-Testo	1470
100	Autobusë mbi 42+1 vende Ri-Testo	1470
101	Autobusë artikularë Ri-Testo	1470
102	Rimorkio deri në 7 tonë Ri-Testo	1470
103	Rimorkio mbi 7 tonë Ri-Testo	1470
104	Mjete ndërtimi deri në 7.5 tonë Ri-Testo	1470
105	Mjete ndërtimi nga 7.5 tonë deri në 18 tonë Ri-Testo	1470
106	Mjete ndërtimi mbi 18 tonë Ri-Testo	1470
107	Mjete nd/punim toke deri në 7.5 ton Ri-Testo	1470
108	Mjete nd/punim toke mbi 7.5 ton Ri-Testo	1470
109	Kamionë (gjysmëkamionë) nga 7.5 deri në 18 tonë Ri-Testo	1470
110	Kamionë (gjysmëkamionë) mbi 18 tonë Ri-Testo	1470
111	Rimorkio (gjysmëkamionë) mbi 7 tonë Ri-Testo	1470
112	Rimorkio të lehta deri 750 kg Ri-Testo	1470
200	Dublikatë certifikate	870

UDHËZIM

Nr. 21, datë 2.8.2013

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR DHËNIEN E MEDALJES SË ARTË

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 2 të nenit 53 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Nxënësve të shkëlqyer në vite, pas përfundimit të arsimit të mesëm të lartë, u jepet “Medalja e artë” nga Presidenti i Republikës, me propozimin e ministrit.

2. Nderohen me medaljen e artë nxënësit që përfundojnë arsimin e mesëm të lartë dhe plotësojnë njëherësh këto kushte:

- a) kanë pikët mesatare për kredit jo më pak se 10.00;
- b) në secilin prej provimeve të detyruara të maturës shtetërore janë vlerësuar me jo më pak se nota e shkallëzuar 9.5;
- c) në provimet me zgjedhje të maturës shtetërore kanë mesataren e notave të shkallëzuar 10.00;
- d) kanë sjellje shumë të mirë gjatë viteve të shkollimit.

3. Nderohen me medaljen e artë nxënësit që janë fitues të njërit prej tri çmimeve të para në olimpiadat ndërkombëtare me më shumë se 15 vende pjesëmarrëse.

Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pasi botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

UDHËZIM
Nr. 23, datë 2.8.2013

PËR NDJEKJEN E GJIMNAZIT ME KOHË TË PJESSHME

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe pikës 2 të nenit 24 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

KREU 1
FUNKSIONIMI

Gjimnazi me kohë të pjesshme zgjat katër vite mësimore (klasa e dhjetë - klasa e trembëdhjetë) dhe funksionon tri ditë në javë, me nga pesë orë në ditë.

KREU 2
REGJISTRIMI

1. Nxënësi që ka dëftesën e lirim të arsimit nëntëvjeçar, të fituar brenda vendit ose një dëftesë e njëvlershme me të, të fituar jashtë vendit, ka të drejtë të regjistrohet në klasën e dhjetë të gjimnazit me kohë të pjesshme.

2. Nxënësi që ka dëftesën e lirim të arsimit tetëvjeçar, të fituar brenda vendit ose një dëftesë e njëvlershme me të, të fituar jashtë vendit, ka të drejtë të regjistrohet në klasën e dhjetë të gjimnazit me kohë të pjesshme.

3. Nxënësi, i parashikuar në pikën 2, jep provimet e plotësimit të klasës së nëntë për lëndët: gjuhë shqipe, matematikë, biologji, fizikë, gjeografi dhe kimi, në periudhën shtator-tetor, ndërkohë që ndjek klasën e dhjetë të gjimnazit me kohë të pjesshme.

4. Provimet zhvillohen vetëm me shkrim, me testet të hartuara dhe vlerësimin të kryer nga komisione të përbëra nga tre mësues të shkollës, ku është regjistruar, të ngritura nga drejtori i asaj shkolle.

5. Nxënësi përsërit klasën e dhjetë kur është jokalues në provimin e të paktën një prej lëndëve të përmendura në pikën 3.

6. Nxënësi, që ka dëftesën e klasës së dhjetë të gjimnazit me kohë të plotë brenda vendit, ka të drejtë të regjistrohet në klasën e njëmbëdhjetë të gjimnazit me kohë të pjesshme.

Në këtë rast nuk përfshihen në planin mësimor të klasës së njëmbëdhjetë lëndët:

“Qytetaria 10”, “Historia 10” dhe “TIK. 10”.

7. Nxënësi, që ka përfunduar klasën e njëmbëdhjetë të gjimnazit me kohë të plotë brenda vendit, ka të drejtë të regjistrohet në klasën e trembëdhjetë të gjimnazit me kohë të pjesshme.

8. Nxënësi, që ka dëftesat e dy ose tri klasave të gjimnazit me kohë të plotë:



a) ka të drejtë të regjistrohet në gjimnazin me kohë të pjesshme në të njëjtën klasë, kur i mungojnë më shumë se gjashtë lëndë njëvlershmërie ose në klasën pasuese, kur i mungojnë jo më shumë se gjashtë lëndë njëvlershmërie;

b) i jep provimet për lëndët që i mungojnë sipas pikës “a” në periudhën shtator-tetor, ndërkohë që ndjek të njëjtën klasë ose klasën pasuese;

c) i jep provimet vetëm me shkrim, me teste të hartuara dhe vlerësimin të kryer nga komisione të përbëra nga tre mësues të shkollës ku është regjistruar, të ngritura nga drejtori i asaj shkolle;

d) përsërit klasën përkatëse, kur është jokalues në provimin e vetëm njëres lëndë të përmendur në pikën “a”.

9. Nxënësi që mbetet në një ose më shumë lëndë në provimet, lëndët mbetëse i jep vitin e ardhshëm shkollor, sipas procedurave të përshkruara më lart, ndërsa lëndët kaluese mbarten.

10. Për t’u regjistruar në klasën e dhjetë të gjimnazit me kohë të pjesshme, nxënësi duhet të paraqesë në Drejtorinë Arsimore Rajonale (DAR) apo Zyrën Arsimore (ZA) dokumentet e mëposhtme:

a) kopje e dokumentit të identifikimit të nxënësit;

b) dëftesa e liritimit ose kur mungon, vërtetimi me notat që përmban dëftesa, lëshuar nga drejtori i shkollës dhe konfirmuar nga DAR/ZA-ja ose kopja e faqes së plotë të amzës, lëshuar nga arkivi i shtetit.

11. Për t’u regjistruar në klasën e ndërmjetme të gjimnazit me kohë të pjesshme, nxënësi duhet të paraqesë në DAR/ZA dokumentet e mëposhtme:

a) dokumenti i identifikimit të nxënësit;

b) dëftesa e përfundimit të klasës paraardhëse ose vërtetimi me notat, kur dëftesa mungon, e lëshuar nga drejtori i shkollës dhe konfirmuar nga DAR/ZA-ja përkatëse.

KREU 3

KURRIKULA NË GJIMNAZIN ME KOHË TË PJESSHME

1. Kurrikula bërthamë e gjimnazit me kohë të pjesshme nuk përfshin lëndët: “Artet”, “Edukimi fizik dhe sportet”, “Karriera dhe aftësimi për jetën”, “Teknologjia” dhe “Shkencat natyrore” të klasës së dymbëdhjetë të gjimnazit me kohë të plotë.

Programet e lëndëve të tjera të kurrikulës bërthamë janë të njëjta me ato të gjimnazit me kohë të plotë.

2. Kurrikula e gjimnazit me kohë të pjesshme nuk ka lëndë me zgjedhje.

3. Vlerësimi ditor dhe vjetor i nxënësve është si në gjimnazin me kohë të plotë.

KREU 4

DETYRAT E DAR/ZA-ve

DAR/ZA ka këto detyra:

a) përcakton gjimnazin (gjimnazet) me kohë të pjesshme;

b) cakton ditët e javës të zhvillimit në to të mësimin sipas propozimit të drejtorit të gjimnazit përkatës;

c) kryen njëvlershmërinë e dokumentacionit të nxënësve që vijnë nga jashtë vendit;

ç) monitoron provimet e njëvlershmërisë në muajt shtator-tetor.

KREU 5
DOKUMENTI SHKOLLOR

1. Në amzë shënohen notat e mbartura dhe notat e provimeve të njëvlershmërisë.
Në amzë bashkëngjiten dëftesa/dëftesat përkatëse dhe një kopje e procesverbalit të provimeve të njëvlershmërisë.
2. Pas përfundimit të gjimnazit me kohë të pjesshme, nxënësi merr:
 - a) dëftesën e klasës së trembëdhjetë, kur përfundon me sukses klasën e trembëdhjetë;
 - b) diplomën e gjimnazit, pas përfundimit me sukses të provimeve të maturës shtetërore.Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore.
Ky udhëzim hyn në fuqi pasi botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

UDHËZIM
Nr. 24, datë 2.8.2013

PËR CERTIFIKIMIN E HARTUESVE TË TESTEVE DHE VLERËSUESVE NË PROVIMET KOMBËTARE

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 49 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 “Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Kandidati për hartimin e testeve lëndore ose vlerësues në provimet kombëtare, më tutje “Kandidati”, është mësuesi që:
 - a) zotëron diplomën universitare në mësuesi për lëndën përkatëse;
 - b) ka dhënë lëndën të paktën një herë në të gjitha klasat e nivelit arsimor;
 - c) ka 5 vjet përvojë si mësues.
2. Mësuesi, që i është nënshtruar provimit të kualifikimit është kandidat, kur është vlerësuar me të paktën “mirë” në këtë provim.
Parapëlqehen mësuesit që janë vlerësuar me të paktën “shumë mirë”.
3. Kandidati për hartues të testeve lëndore në provimet kombëtare ose vlerësues në provimet e maturës shtetërore paraqet pranë Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP), kurse kandidati për vlerësimin në provimet e lirimit paraqet pranë njësisë arsimore vendore përkatëse (DAR/ZA):
 - a) CV-në e tij sipas modelit në shtojcën 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi;
 - b) dy rekomandime nga drejtues të shkollave ose specialistë të njësisë arsimore vendore për cilësinë e punës së tij dhe qëndrimin e tij etik.
4. Kandidatët marrin pjesë në një kurs afatshkurtër, me materiale të përgatitura nga AKP dhe të miratuara nga MASH.
5. Kandidatët për hartimin e testeve lëndore ose për vlerësimin në provimet e maturës shtetërore:
 - a) marrin pjesë në kursin afatshkurtër të zhvilluar nga specialistë të AKP-së;
 - b) i nënshtrohen provimit me teste të hartuara nga AKP-ja;
 - c) pajisen me certifikatën përkatëse kur përfundojnë me sukses provimin.
6. Kandidatët për vlerësimin në provimet e lirimit:



a) marrin pjesë në kursin afatshkurtër të zhvilluar nga specialistë të sektorit të kurrikulës në njësinë arsimore vendore, të cilët përgatiten paraprakisht nga specialistë të AKP-së;

b) pajisen me certifikatën përkatëse kur kanë marrë pjesë në të gjitha seancat e kursit afatshkurtër.

7. AKP dhe DAR/ZA-të:

a) publikojnë në faqen e tyre të internetit materialet për hartimin e testeve lëndore dhe vlerësimin;

b) datat e kurseve afatshkurtra që zhvillohen nga AKP dhe DAR/ZA-ja;

c) datat e provimeve dhe vendin e zhvillimit të tyre për AKP-në.

8. AKP harton dokumentin që përshkruan:

a) procedurat e zhvillimit të provimit të kandidatëve;

b) procedurat e vlerësimit të kandidatëve;

c) formatin dhe përmbajtjen e certifikatës të lëshuar nga AKP dhe DAR/ZA.

9. Kanë të drejtë të hartojnë teste lëndore dhe të vlerësojnë në provimet kombëtare vetëm mësuesit e certifikuar sipas këtij udhëzimi.

10. Certifikata për provimet e maturës shtetërore është e vlefshme edhe për provimet e lirimit.

Mësuesi, i certifikuar për provimet e lirimit, e fiton certifikatën e provimeve të maturës shtetërore pasi të përfundojë me sukses provimin përkatës të vlerësimit.

11. AKP përzgjedh për një vit shkollor mësuesit e certifikuar prej saj si hartues të testeve lëndore dhe vlerësues në maturës shtetërore.

12. DAR/ZA përzgjedh për një vit shkollor mësuesit e certifikuar si vlerësues të provimeve të lirimit.

13. Certifikata e kandidatëve fitues lëshohet nga:

a) AKP për hartimin e testeve lëndore dhe vlerësimin në provimet e maturës shtetërore;

b) DAR/ZA për vlerësimin në provimet e lirimit,
dhe firmoset e vuloset nga titullari përkatës.

14. Certifikata është e vlefshme për një periudhë pesëvjeçare.

Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Agjencia Kombëtare e Provimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

UDHËZIM
Nr. 25, datë 2.8.2013

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QEVERISË SË NXËNËSVE

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 36 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

KREU 1

STATUSI, MISIONI, TË DREJTAT DHE DETYRAT E QEVERISË SË NXËNËSVE

I. Statusi

Qeveria e nxënësve është organizëm që ngrihet me nismën e nxënësve të shkollës.

II. Misioni

Qeveria e nxënësve është një organizëm i ngritur në çdo shkollë dhe ka për mision:

- a) të mbrojë dhe të promovojë të drejtat e nxënësve;
- b) të kontribuojë në plotësimin dhe zhvillimin e interesave të nxënësve;
- c) të ndihmojë në mbarëvajtjen e shkollës;
- d) të përfaqësojë nxënësit e shkollës në marrëdhëniet me drejtorinë e shkollës, komunitetin dhe nxënësit e shkollave të tjera.

III. Të drejtat e qeverisë së nxënësve

Qeveria e nxënësve ka të drejtë:

- a) të parashtojë shqetësimet e saj për mbrojtjen e të drejtave të nxënësve të shkollës dhe propozimet për mbarëvajtjen e shkollës te drejtori i shkollës, këshilli i mësuesve, këshilli i prindërve dhe bordi i shkollës;
- b) të ketë një vend në shkollë ku të afishojë lajmërimet e veta;
- c) të botojë gazetën e qeverisë së nxënësve;
- d) të bashkëpunojë me qeveri homologe nxënësish për organizimin e veprimtarive të përbashkëta;
- e) t'i drejtohet komisionit të etikës dhe sjelljes të shkollës dhe çdo organizimi tjetër për çdo formë veprimi ose mosveprimi që mund të shkaktojë diskriminim, dhunë, keqtrajtim ose dëm moral të nxënësit në mjediset e shkollës.

IV. Detyrat e qeverisë së nxënësve

Qeveria e nxënësve ka për detyrë:

- a) të organizojë veprimtari nëpërmjet të cilave nxënësve u jepet mundësia të dëgjohen nga drejtuesit dhe mësuesit e shkollës për idetë në të mirë të tyre dhe të shkollës;
- b) të organizojë veprimtari të nxënësve në dobi të shkollës;
- c) të kontribuojë në krijimin e një klime pozitive në shkollë, veçanërisht në zgjidhjen e konflikteve nxënës-nxënës, nxënës-mësues;
- d) të kontribuojë në parandalimin dhe pakësimin e abuzimit të nxënësve me duhanin, alkoolin dhe drogat, si dhe të braktisjes së shkollës;
- e) të organizojë ndihmë ndaj nxënësve me vështirësi në të nxënë ose me probleme sociale.

KREU 2

NGRITJA E QEVERISË SË NXËNËSVE, PËRBËRJA DHE FUNKSIONIMI I SAJ

I. Ngritja e qeverisë së nxënësve dhe përbërja e saj

1. Qeveria e nxënësve ngrihet në bazë shkolle.
2. Zgjedhjet për qeverinë e nxënësve bëhen në fillim të çdo viti mësimor.
3. Në shkollën bazë përfaqësohen në qeverinë e nxënësve klasat 6 - 9.
4. Ku shkolla është vetëm fillore, përfaqësohen në qeverinë e nxënësve klasat 4 - 6.
5. Anëtarët e qeverisë së nxënësve zgjidhen sipas kësaj procedure:
 - a) Kur një klasë ka vetëm një deri në katër paralele, nxënësit, nën kujdesin e mësuesve kujdestarë përkatës, zgjedhin për çdo klasë paralele nga një anëtar të qeverisë së nxënësve.
 - b) Kur një klasë ka më shumë se katër paralele, çdo klasë paralele, nën kujdesin e mësuesit



kujdestar përkatës, zgjedh me shumicë votash tre nxënës, të cilët formojnë së bashku përfaqësuesit e paraleleve të një klase.

Përfaqësuesit e paraleleve të një klase, nën kujdesin e një mësuesi të caktuar nga drejtori, zgjedhin me shumicë të thjeshtë votash të fshehta, katër anëtarë të qeverisë së nxënësve.

6. Për shkollën bazë dhe për shkollën fillore kur është më vete, kryetari i qeverisë zgjidhet një anëtar i qeverisë, me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të saj, me konkurrimin e më shumë se një kandidati për rolin e kryetarit.

7. Për arsimin e mesëm të lartë, kryetari i qeverisë zgjidhet një nga anëtarët e qeverisë, me votë të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë të nxënësve të shkollës, me konkurrimin e më shumë se një kandidati për rolin e kryetarit.

8. Kryetari i qeverisë nuk duhet të ketë lidhje familjare me drejtorin e shkollës.

II. Funksionimi i qeverisë së nxënësve

1. Qeveria e nxënësve funksionon në përputhje me legjislacionin në fuqi, rregulloren e brendshme të shkollës dhe rregulloren e saj.

2. Rregullorja e qeverisë së nxënësve hartohet nga grupe pune me nxënës dhe miratohet nga qeveria e saj pasi është marrë pëlqimi nga bordi dhe drejtori i shkollës.

3. Qeveria e nxënësve ka nënkryetarin dhe sekretarin, të cilët zgjidhen në mbledhjen e parë të saj.

4. Anëtarët e qeverisë së nxënësve kanë detyra që mbulojnë aspekte të veçanta të veprimtarisë së shkollës, si dhe klasa të caktuara, veçanërisht të fillores për qeverinë e nxënësve të arsimit bazë.

5. Qeveria e nxënësve informon rregullisht nxënësit për veprimtarinë e saj.

6. Qeveria e nxënësve:

a) harton dhe zbaton planin e saj vjetor në bashkëpunim me nxënës të shkollës;

b) përgatit raportin vjetor të veprimtarisë së saj, të cilin ia dërgon drejtorisë, kryetarit të bordit dhe kryetarit të këshillit të prindërve dhe mundëson leximin e këtij raporti nga nxënësit e shkollës.

7. Në mbledhjet e qeverisë së nxënësve ftohen përfaqësues të klasave të fillores për qeverinë e nxënësve të arsimit bazë, nga bordi i shkollës, drejtorja, këshilli i prindërve të shkollës, mësues, përfaqësues të OJF-ve.

III. Veprimtari të qeverisë së nxënësve

Qeveria e nxënësve:

1. Merr nisma për veprimtari jashtëkurrikulare jopolitike të nxënësve dhe i organizon ato në bashkëpunim me drejtorinë e shkollës.

2. Përgatit dhe realizon projekte, në bashkëpunim me drejtorinë e shkollës, për plotësimin dhe zhvillimin e interesave të nxënësve.

3. Zhvillon pyetësorë mbi kënaqësinë e nxënësve për shërbimin që shkolla siguron ose për aspekte të veçanta të jetës shkollërore të nxënësve.

4. Boton gazetën e qeverisë së nxënësve të shkollës.

IV. Mësuesi ndihmës

1. Qeveria e nxënësve:

a) përzgjedh mësuesin ndihmës, i cili e ndihmon në hartimin dhe zbatimin e veprimtarive të saj dhe, në veçanti, në hartimin e rregullores së qeverisë së nxënësve;

b) kërkon zëvendësimin e mësuesit ndihmës të saj kur mësuesi ndihmës nuk kryen detyrat e tij.

2. Drejtori i shkollës emëron mësuesin ndihmës.

3. Mësuesit ndihmës nuk i jepet klasë në kujdestari, me përjashtim të rasteve kur në shkollë ekzistojnë klasa pa mësues kujdestar.

KREU 3
DREJTORI I SHKOLLËS DHE QEVERIA E NXËNËSVE

I. Detyrat kryesore të drejtorit të shkollës

Drejtori i shkollës ka për detyrë:

a) t'i verë në dispozicion qeverisë së nxënësve dokumentet zyrtare që kanë të bëjnë me veprimtarinë e saj dhe të shkollës, si ligji për sistemin arsimor parauniversitar, dispozitat normative dhe akte të tjera nënligjore;

b) të takojë një herë në dy muaj qeverinë e nxënësve për të dëgjuar shqetësimet dhe propozimet e saj;

c) t'i sigurojë qeverisë së nxënësve një mjedis ku të zhvillojë veprimtaritë e saj, të ruajë arkivin e saj dhe të caktojë një vend ku qeveria e nxënësve të afishojë lajmërimet;

d) të përfshijë përfaqësues të qeverisë së nxënësve në grupet e punës që hartojnë rregulloren e shkollës, planin afatmesëm dhe planin e saj vjetor;

e) të ftojë kryetarin në mbledhje të këshillit të mësuesve, kur shqyrtohen çështje që kanë të bëjnë me kontributin e qeverisë së nxënësve.

II. Detyrimet e qeverisë së nxënësve ndaj drejtorit të shkollës

Kryetari i qeverisë së nxënësve i kërkon leje me shkrim drejtorit të shkollës për veprimtari jashtëkurrikulare të qeverisë së nxënësve, të cilat i organizon në mjediset e shkollës ose jashtë saj.

Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe drejtoritë arsimore rajonale e zyrat arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

UDHËZIM
Nr. 26, datë 2.8.2013

PËR PËRCAKTIMIN E DETYRAVE DHE FUNKSIONEVE TË KËSHILLIT TË
MËSUESVE

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 35 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

KREU 1
FUNKSIONET E KËSHILLIT TË MËSUESVE

Këshilli i mësuesve ka për funksion:

a) të shqyrtojë zbatimin e akteve të legjislacionit arsimor dhe të këshillojë përmirësime në drejtimin e institucionit;

b) të analizojë periodikisht arritjet e nxënësve dhe të këshillojë përmirësimet në veprimtarinë e institucionit arsimor që çojnë në arritje më të mira të nxënësve;

c) të marrë pjesë në procedurat e emërimit dhe të largimit të mësuesit, drejtorit dhe nëndrejtorit të institucionit arsimor.



KREU 2 DETYRA TË KËSHILLIT TË MËSUESVE

Këshilli i mësuesve ka për detyrë:

- a) të shqyrtojë rregullisht përvojat e suksesshme të mësuesve të institucionit;
- b) të shqyrtojë praktikën e suksesshme të kolegëve të institucioneve arsimore vendase dhe të sugjerojë mënyrat e zbatimit të tyre;
- c) të kryejë studime për praktikën e suksesshme të institucioneve analoge të huaja dhe të sugjerojë mënyrat e zbatimit të tyre.

Këto funksione realizohen nga grupe mësuesish ose mësues të veçantë të caktuar nga drejtori i institucionit arsimor ose të propozuar paraprakisht nga mësuesit.

KREU 3 ORGANIZIMI I MBLEDHJEVE TË KËSHILLIT TË MËSUESVE

1. Këshilli i mësuesve mbledhet, si rregull, jo më pak se një herë në muaj.

Këshilli mbledhet edhe në rastet kur e gjykon të arsyeshme drejtori i institucionit arsimor ose kur e kërkon jo më pak se 1/3 e anëtarëve të tij.

2. Mbledhjen e parë të këshillit të mësuesve e zhvillon të paktën dhjetë ditë para fillimit të vitit shkollor.

Në këtë mbledhje të këshillit i jep mendime drejtorit për:

- formimin e klasave;
- orarin mësimor;
- tematikat e përafërta të mbledhjeve të zakonshme të këshillit;
- veprimtaritë e zhvillimit të brendshëm profesional;
- çështje të tjera, sipas kërkesës së drejtorit ose me nismën e këshillit.

3. Në përfundim të vitit mësimor, këshilli i mësuesve analizon veprimtarinë vjetore të institucionit dhe rekomandon synimin dhe objektivat për vitin e ardhshëm.

4. Drejtori i institucionit arsimor vendos që në mbledhje të caktuara të këshillit të mësuesve të bëjnë pjesë, mësuesit ndihmës dhe instruktorët, si dhe nga personeli i konviktit dhe personeli ndihmës (nëse ka të tillë).

5. Në mbledhjet e këshillit të mësuesve, drejtori ka të drejtë të ftojë përfaqësues të njësive bazë përkatëse të qeverisjes vendore, të njësive arsimore vendore, punonjësin psiko-social, kryetarin e bordit, kryetarin e këshillit të prindërve, kryetarin e qeverisë së nxënësve, kryetarin e komisionit të etikës dhe sjelljes ose të deleguar të tyre, personelin mjekësor të shkollës (kur ka të tillë), si dhe përfaqësues të tjerë nga komuniteti.

6. Drejtori cakton një mësues si sekretar të këshillit.

Sekretari mban shënimet e mbledhjeve në protokollin e Këshillit të Mësuesve dhe vendos në arkivin e institucionit materialet e paraqitura në këshill nga drejtuesit e institucionit dhe mësuesit.

Dokumentacioni i këshillit të mësuesve është objekt i kontrollit të Inspektoratit Shtetëror të Arsimit.

Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

UDHËZIM
Nr. 27, datë 2.8.2013

PËR BORDIN E INSTITUCIONIT ARSIMOR

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 34 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

KREU 1
TË DREJTAT E BORDIT TË INSTITUCIONIT ARSIMOR

Bordi ka të drejtë:

- a) t'i kërkojë drejtorit të institucionit (drejtorit) t'i raportojë për kushtet e të nxënësve, arritjet e nxënësve dhe për aspekte të zbatimit të legjislacionit në institucion;
- b) të ftojë për t'u kërkuar mendim: nëndrejtor, mësues, kryetarin e këshillit të prindërve kryetarin e qeverisë së nxënësve, specialistë dhe përfaqësues nga OJF-të;
- c) t'i drejtohet me shkrim ose të takojë përfaqësues të njësisë arsimore vendore dhe njësisë bazë të qeverisjes vendore për përmirësimin e kushteve të të nxënësve në institucion.

KREU 2
DETYRAT E BORDIT

1. Bordi ka për detyrë:

- a) të miratojë planin afatmesëm dhe atë vjetor të institucionit;
- b) të miratojë planin e shpenzimeve të institucionit arsimor për fondet, të cilat sigurohen nga institucioni;
- c) të miratojë kurrikulën e hartuar nga institucioni arsimor;
- d) të marrë pjesë në procedurat e emërimit e të largimit të drejtorit të institucionit arsimor dhe të mësuesit;
- e) të shqyrtojë rregulloren e brendshme të institucionit;
- f) të miratojë hapjen dhe mbylljen e shërbimeve të institucionit për të tretët;
- g) të shqyrtojë raportin vjetor financiar të institucionit;
- h) të ndjekë përmbushjen e objektivave të planit vjetor të institucionit.

2. Bordi përpaket për të siguruar kontribute të ligjshme vendase ose të huaja për mbarëvajtjen e institucionit.

3. Kryetari i bordit i raporton këshillit të prindërve të institucionit për veprimtarinë e bordit, në një takim të përbashkët të bordit dhe këshillit të prindërve në fund të vitit shkollor.

KREU 3
PËRBËRJA E BORDIT

1. Bordi ka kryetarin dhe sekretarin e tij.

2. Bordi i institucionit përbëhet nga prindër të nxënësve, mësues, përfaqësues i njësisë bazë të qeverisjes vendore përkatëse, nxënës (kur është e mundur) dhe pjesëtarë të tjerë të komunitetit (me ndikim në komunitet, nga bota e biznesit, përfaqësues të OJF-ve, të cilët nuk janë prindër të nxënësve).



3. Drejtori i institucionit arsimor nuk bën pjesë në bord.

4. Në institucionet arsimore me më pak se 24 klasa, në kohën kur bordi ngrihet, ai përbëhet nga pesë vetë.

Ky bord ka 1 mësues, 1 prind, 1 nxënës, 1 pjesëtar tjetër të komunitetit dhe përfaqësuesin e njësisë bazë të qeverisjes vendore përkatëse.

Kur bordi nuk ka nxënës, përbëhet nga 1 mësues, 2 prindër, 1 pjesëtar tjetër të komunitetit dhe përfaqësuesi i njësisë bazë të qeverisjes vendore përkatëse.

Në institucionet arsimore me të paktën 24 klasa, bordi përbëhet nga shtatë vetë. Ky bord ka 1 mësues, 2 prindër, 2 nxënës, 1 pjesëtar tjetër të komunitetit dhe përfaqësuesi i njësisë bazë të qeverisjes vendore përkatëse.

Kur bordi nuk ka nxënës, përbëhet nga 1 mësues, 3 prindër, 2 pjesëtarë të tjerë të komunitetit dhe përfaqësuesi i njësisë bazë të qeverisjes vendore përkatëse.

5. Prindërit zgjidhen me shumicë votash të fshehta nga këshilli i prindërve.

Mësuesi zgjidhet me shumicë votash të fshehta nga këshilli i mësuesve.

Nxënësit zgjidhen me shumicë votash nga qeveria e nxënësve.

Pjesëtarët e tjerë të komunitetit përfshihen në bord me nismën e tyre dhe përzgjidhen me votim të fshehtë nga anëtarët e tjerë të bordit.

6. Përfaqësuesi në bord i njësisë bazë të qeverisjes vendore caktohet nga këshilli i bashkisë ose i komunës përkatëse.

7. Në bord bën pjesë, pa të drejtë vote, një përfaqësues i njësisë arsimore vendore ose një i deleguar i saj, i cili merr pjesë rregullisht në mbledhjet e bordit.

8. Kryetari dhe anëtarët e bordit:

a) nuk duhet të kenë lidhje familjare me drejtorin (bashkëshort/bashkëshorte, prind, vëlla/motër, fëmijë në moshë madhore, prindër të bashkëshortit a bashkëshortes);

b) nuk duhet të kenë precedentë penalë;

c) të mos jenë në forumet drejtuese të partive politike.

KREU 4

NGRITJA E BORDIT

1. Përgjegjësinë për ngritjen e bordit të një institucioni arsimor e ka përfaqësuesi i njësisë arsimore vendore në bord (përfaqësuesi).

2. Titullari i njësisë arsimore vendore siguron nga njësia bazë e qeverisjes vendore listën e përfaqësuesve të tyre në bordet e institucioneve arsimore përkatëse.

3. Përfaqësuesi drejton mbledhjet e këshillit të mësuesve për zgjedhjen e mësuesit në bord dhe organizon përfshirjen në bord të pjesëtarëve të tjerë nga komuniteti.

KREU 5

FUNKSIONIMI I BORDIT

1. Bordi funksionon për një periudhë trevjeçare.

2. Bordi mbledhet jo më pak se tri herë në vit. Mbledhjet e tjera zhvillohen ose me nismën e kryetarit të bordit ose të shumicës së thjeshtë të anëtarëve të tij.

3. Mbledhja e bordit zhvillohet kur marrin pjesë jo më pak se 3/5 e anëtarëve të tij, përndryshe shtyhet.

4. Bordi i merr vendimet me shumicë të thjeshtë votash. Vendimet nënshkruhen nga kryetari dhe sekretari.

5. Veprimtaria e anëtarëve të bordit është vullnetare dhe nuk paguhet.

6. Kryetari dhe anëtari i bordit largohet nga bordi kur gjatë dy viteve të njëpasnjëshme mungon në të paktën gjysmën e mbledhjeve të tij.

Zëvendësimi i tyre dhe çdo zëvendësim tjetër kryhet sipas procedurave të përshkruara në këtë udhëzim.

KREU 6 KRYETARI I BORDIT

Kryetari i bordit:

- a) zgjidhet në mbledhjen e parë të bordit me shumicën e thjeshtë të votave të fshehta (kryetari i bordit nuk është mësues);
- b) drejton veprimtarinë e bordit;
- c) drejton ndarjen e detyrave ndërmjet anëtarëve të bordit;
- d) drejton hartimin dhe zbatimin e planit vjetor të bordit;
- e) shkarkohet me shumicë të thjeshtë të votave të fshehta të anëtarëve të bordit për moskryerje të detyrave të tij.

KREU 7 SEKRETARI I BORDIT

1. Mësuesi, anëtar i bordit, është sekretar i bordit.

2. Sekretari:

- a) përgatit materialet që do të shpërndahen në mbledhjet e bordit;
- b) mban shënimet e mbledhjeve të bordit;
- c) lajmëron anëtarët e bordit dhe të ftuarit për mbledhjen e radhës;
- d) mban arkivin e bordit në një mjedis të institucionit.

KREU 8 DREJTORI I INSTITUCIONIT DHE BORDI

Drejtori i institucionit ka për detyrë:

- a) t'i dorëzojë kryetarit të bordit kopje të udhëzimeve e rregulloreve të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës dhe të titullarit të njësisë arsimore vendore, të cilat i përkatësin veprimtarisë së institucionit;
- b) t'i raportojë bordit për çështje të mbarëvajtjes së shkollës për të cilat kryetari i bordit i paraqet drejtorit kërkesë me shkrim;
- c) t'i dorëzojë kryetarit të bordit një kopje të raportit të inspektimit, rezultatet e nxënësve të shkollës në provimet kombëtare dhe çdo studim që krahason institucionin me institucionet e tjera;
- d) t'i sigurojë bordit një mjedis për zhvillimin e takimeve të tij;
- e) t'i sigurojë bordit një vend për arkivin e tij.

KREU 9 DISPOZITA E FUNDIT

Ky udhëzim është i zbatueshëm për institucionet e arsimit parauniversitar publik, përveç institucioneve të arsimit dhe formimit profesional.

Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj



UDHËZIM
Nr. 29, datë 2.8.2013

PËR PROCEDURAT E NDJEKJES SË ARSIMIT BAZË ME KOHË TË PJESSHME

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe të pikës 4 të nenit 22 të ligjit nr. 69, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

KREU 1
PROCEDURAT E REGJISTRIMIT

1. Nxënësit që kanë mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe nuk e kanë përfunduar arsimin bazë me kohë të plotë, kanë të drejtë të regjistrohen në shkollat e arsimit bazë me kohë të pjesshme.

2. Dokumentet që duhen për regjistrim janë:

- a) kërkesë për regjistrim pranë shkollës;
- b) kopje e kartës së identitetit të nxënësit;
- c) dëftesë ose vërtetim me nota për klasën e fundit të kryer.

3. Nxënësi, që ka kryer një ose disa vite shkollimi jashtë shtetit, regjistrohet në klasën përkatëse sipas njëvlershmërisë së dokumentit shkollor.

KREU 2
KURRIKULA

- 1. Arsimi bazë me kohë të pjesshme zgjat nëntë vite shkollore (klasat I-IX).
- 2. Shkolla me kohë të pjesshme funksionon me tri ditë në javë (me klasa të veçanta ose të bashkuara).
- 3. Plani mësimor dhe programet lëndore të arsimit bazë me kohë të pjesshme hartohen nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit dhe miratohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.
- 4. Plani mësimor dhe struktura e vitit shkollor njoftohen në udhëzimin e vitit shkollor.

KREU 3
VLERËSIMI I NXËNËSVE, KALIMI I KLASËS

- 1. Vlerësimi ditor e vjetor i nxënësve, kalimi i klasës dhe sesioni i vjeshtës në shkollën me kohë të pjesshme, është si në shkollën me kohë të plotë.
- 2. Nxënësi kalues i klasës së nëntë ka të drejtë të japë provimet e lirim.

KREU 4
DETYRAT E DREJTORIVE ARSIMORE RAJONALE/ZYRAVE ARSIMORE

Drejtoritë arsimore rajonale/zyrat arsimore përcaktojnë shkollën ose shkollat me kohë të pjesshme për arsimin bazë.

KREU 5 SHANSI I DYTË

1. Fëmijët e moshës së detyrimit shkollor që kanë braktisur shkollën, e ndërpresin ose nuk e kanë ndjekur dhe nuk kthehen në shkollën bazë me kohë të plotë dhe as nuk ndjekin shkollën bazë me kohë të pjesshme, kanë të drejtë të ndjekin shkollimin e quajtur “shansi i dytë”.

2. Nxënësi ka të drejtë të ndjekë “shansin e dytë” deri në moshën shtatëmbëdhjetë vjeç. Nxënësi, që ka mbushur moshën shtatëmbëdhjetë vjeç dhe nuk ka përfunduar “shansin e dytë”, lejohet të përfundojë klasën që po ndjek.

3. Viti mësimor në klasat e shansit të dytë zgjat 30 javë. Mësimi zhvillohet tri herë në javë. Ora e mësimi zgjat 45 minuta.

4. Plan mësimor dhe programet lëndore hartohen nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit dhe miratohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

5. Plan mësimor parashikon module për t’u përvetësuar nga të gjithë nxënësit e “shansit të dytë”.

6. DAR/ZA cakton shkollën (shkollat) e arsimit bazë me kohë të plotë në të cilat do të zhvillohet “shansi i dytë”.

7. Ndarja e nxënësve sipas klasave të “shansit të dytë” bazohet në vlerësimin e njohurive të secilit nxënësi nga një komision i ngritur nga drejtori i shkollës dhe i përbërë nga mësues të saj.

8. Aty ku numri i nxënësve në dy klasa të “shansit të dytë” është më i vogël se numri i nxënësve për klasë, punohet me klasa të bashkuara, duke parapëlqyer bashkimin e klasave I-III, IV-VI dhe VII-IX.

9. Shkolla, që realizon “shansin e dytë” u vë në dispozicion klasave të shansit të dytë mjetet mësimore, laboratorët dhe kabinetet e TIK-ut, si dhe i përfshin nxënësit e këtyre klasave në veprimtaritë jashtëshkollore që organizohen me klasat e zakonshme.

10. Mësuesit që punojnë në “shansin e dytë” kur e shohin të nevojshme, hartojnë dhe zbatojnë programe lëndore të individualizuara me synim realizimin e objektivave bazë të programeve të zakonshme lëndore.

11. Mësuesit mbajnë regjistër të veçantë për nxënësit e “shansit të dytë”.

12. Personi i ngarkuar për amzën e plotëson për çdo nxënësi të “shansit të dytë”.

13. Ekipet lëndore të shkollës trajtojnë posaçërisht aspekte të zhvillimit profesional të mësuesve që punojnë me nxënësit e “shansit të dytë”.

14. Mësuesi kujdestar i klasës së “shansit të dytë” përqendrohet në:

a) motivimin e nxënësve për të vijuar dhe për të nxënë rregullisht;

b) bashkëpunimin me prindërit e nxënësve.

15. Psikologu/punonjësi social në shkollë u kushtojnë vëmendje të posaçme nxënësve të “shansit të dytë”.

16. Drejtori i shkollës dhe specialistët e kurrikulës në DAR/ZA vëzhgojnë orë mësimore në klasat e “shansit të dytë”, për të dhënë ndihmesën në përmirësimin e vazhdueshëm të punës në to.

17. Në përfundim të çdo klase të “shansit të dytë” nxënësi pajiset me dëftesë të veçantë klase, ndërsa në përfundim të arsimit bazë ai pajiset me dëftesën e veçantë të arsimit bazë.

Formati i dëftesave përcaktohet nga MASH.

18. Nxënësit e “shansit të dytë” që përfundojnë klasën e nëntë dhe hyjnë e janë kalues në provimet e zakonshme të lirim, pajisen me dëftesën e lirim.

19. DAR/ZA-të dhe shkollat bashkëpunojnë me OJF-të dhe njësitë bazë të qeverisjes vendore për t’u siguruar nxënësve të “shansit të dytë” lehtësira në ndjekjen e mësimave për ta ose/dhe familjeve të tyre.

Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore.



Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

UDHËZIM
Nr. 30, datë 2.8.2013

PËR RREGULLOREN TIP TË INSTITUCIONEVE ARSIMORE

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 26 pika 2 germa “e” e ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”

UDHËZOJ:

KREU I
TË PËRGJITHSHME

1. Institucioni arsimor parauniversitar funksionon sipas legjislacionit në fuqi dhe rregullores së tij të brendshme

2. Rregullorja e brendshme e institucionit arsimor është në përputhje me ligjin nr. 69/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij dhe dispozitat normative.

3. Rregullorja e brendshme e institucionit arsimor:

a) hartohet nën drejtimin e drejtorit të institucionit arsimor, nga grupe të gjera pune që përbëhen nga mësues, nxënës, prindër dhe përfaqësues të tjerë nga komuniteti;

b) paraqitet për shqyrtim nga drejtori i institucionit arsimor te bordi i institucionit;

c) paraqitet për miratim nga drejtori i institucionit arsimor te titullari i njësisë arsimore vendore përkatëse.

4. Nxënësit dhe prindërit e tyre kanë të drejtë të informohen për rregulloren e brendshme të institucionit arsimor. Drejtori i institucionit ka për detyrë të organizojë informimin e tyre.

5. Me propozim të drejtorit të institucionit arsimor, të kryetarit të bordit të institucionit arsimor, të këshillit të prindërve, të qeverisë së nxënësve ose të paktën të 1/3-ës së mësuesve me kohë të plotë, nisin procedurat për ndryshimin e neneve ose përfshirjen e neneve të reja në rregulloren e brendshme të institucionit arsimor.

KREU II
PËRMBAJTJA E RREGULLORES SË BRENDSHME TIP TË INSTITUCIONIT ARSIMOR

Rregullorja e brendshme tip e institucionit arsimor ka përmbajtjen e mëposhtme:

1. Regjistrimi i nxënësve:

a) Kriteret e pranimit për regjistrim në klasën e parë ose të dhjetë të nxënësve të zonave të tjera;

b) Procedura e shortit për pranimet në shkollat profesionale, gjimnazet gjuhësore dhe seksionet dygjuhëshe kur vlera e mesatares së notave të provimeve të liritimit përfshin më shumë nxënës nga sa mund të pranohen.

2. Organizimi në institucionin arsimor:

- a) përcaktimi i numrit të anëtarëve të drejtorisë së institucionit arsimor;
- b) përcaktimi i minutave të pushimit ndërmjet orëve mësimore, 5 ose 10 dhe të pushimit të madh, pas orës së dytë apo të tretë;
- c) funksionimi i mësuesve ditor;
- d) përcaktimi i numrit të mësuesve, prindërve dhe nxënësve në komisionin e etikës dhe sjelljes;
- e) përcaktimi i lexuesve të tjerë të bibliotekës së institucionit, përveç mësuesve dhe nxënësve.

3. Siguria, mirëmbajtja në institucionin arsimor:

- a) veprimet konkrete që kryhen në raste emergjence;
- b) procedurat e pranimit të njerëzve të panjohur në mjediset e institucionit;
- c) procedurat e mirëmbajtjes rutinë ditore dhe javore të institucionit arsimor.

4. Punonjësi i institucionit arsimor:

- a) uniforma e punonjësit të institucionit arsimor (drejtuesit, mësuesit, instruktorët);
- b) nderime për punonjësit, përveç atyre që përshkruhen në dispozitat normative;
- c) ndalime për punonjësin e institucionit arsimor përveç atyre që përshkruhen në dispozitat normative.

5. Vlerësimi i nxënësve

Procedurat e shortit për vlerësimin vjetor të nxënësve në disa klasa, për disa lëndë.

6. Mësuesi

Detajimi i pikës 2 (c) të nenit 60 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”.

7. Nxënësi:

- a) veshja e nxënësit në mjediset e shkollës dhe uniforma e tij;
- b) nderime të tjera dhe shpërblime për nxënësit, përveç atyre që përshkruhen në dispozitat normative;
- d) kriteret e shpalljes së pesë nxënësve me rezultate më të larta gjatë vitit mësimor në shkollat profesionale dhe ato të orientuara.

Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

UDHËZIM

Nr. 31, datë 2.8.2013

**PËR PROCEDURAT E NDJEKJES SË ARSIMIT BAZË PËR NXËNËSIT QË NUK KANË
NDJEKUR TË PAKTËN DY KLASA TË ARSIMIT BAZË**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 5 të nenit 22 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”,



UDHËZOJ:

KREU 1

TË DREJTAT E NXËNËSVE QË NUK KANË NDJEKUR TË PAKTËN DY KLASA TË ARSIMIT BAZË

Gëzojnë të drejtën për të ndjekur arsimin bazë me kohë të plotë, brenda moshës së arsimit të detyruar, sipas procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim, fëmijët që, për arsye të ndryshme:

- a) kanë mbushur të paktën moshën tetë vjeç dhe nuk janë regjistruar në klasën e parë ose e kanë ndërprerë atë;
- b) nuk kanë përfunduar një klasë të arsimit bazë dhe nuk janë regjistruar në atë klasë në vitin pasues;
- c) kanë përfunduar një klasë të arsimit bazë dhe nuk janë regjistruar në të paktën dy vitet shkollore pasuese;
- d) janë mbetës në një klasë dhe nuk e kanë përsëritur për të paktën dy vite shkollore pasuese.

KREU 2

PROCEDURAT E REGJISTRIMIT

1. Prindi i fëmijës, që është në një nga rrethanat e parashikuara në kreun 1, i drejton kërkesën Drejtorisë Arsimore Rajonale (DAR)/Zyrës Arsimore (ZA) përkatëse për regjistrimin e fëmijës.
2. DAR/ZA cakton shkollën e arsimit bazë ku fëmija do të regjistrohet.
3. Prindi, regjistron fëmijën në shkollë sipas procedurave të regjistrimit të zakonshëm të parashikuara në dispozitat normative.
4. Fëmija regjistrohet në klasën me grup-moshë të afërt me moshën e fëmijës ose një vit më shumë se kjo grup-moshë.

KREU 3

PROCESI I MËSIMDHËNIES E I NXËNIES DHE I VLERËSIMIT

1. Drejtoria e shkollës, në bashkëpunim me mësuesin kujdestar të fëmijës, organizojnë hartimin nga mësuesit përkatës të programeve individuale të mësimdhënies dhe nxënies.
2. Në programin mësimor individual, në përgjithësi, mësuesi lëndor vendos nivelin bazë të objektivave të programit të klasës, të cilën nxënësi nuk e ka ndjekur ose përfunduar, ose është mbetës.
Prindi i fëmijës ka të drejtë të kërkojë hartimin e një programi individual mbi nivelin bazë.
3. Mësuesi ose mësuesit e fëmijës punojnë në mënyrë të diferencuar me fëmijën brenda dhe jashtë klasës.
4. Drejtoria e shkollës, në bashkëpunim me mësuesin kujdestar, përpiqen t'i sigurojnë fëmijës ndihmë plotësuese nëpërmjet:
 - a) "mësuesve vullnetarë", që janë prindër ose persona të tjerë nga komuniteti;
 - b) bashkëpunimit me qeverinë e nxënësve;
 - c) mësuesve ndihmës.
5. Fëmija vlerësohet sipas procedurave të vlerësimit të nxënësve të klasës për të cilën po mëson.
6. Vlerësimet shënohen në regjistrin e klasës përkatëse, në një faqe të veçantë.
7. Fëmija kalon klasën, i nënshtrohet provimit të vjeshtës ose përsërit klasën, sipas rregullave të klasës për të cilën po mëson.

KREU 4
DISPOZITA E FUNDIT

Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe DAR/ZA-të.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

UDHËZIM
Nr. 34, datë 2.8.2013

**PËR PLANIFIKIMIN E FONDEVE BUXHETORE DHE NDJEKJEN E PROCEDURAVE TË
PROKURIMIT PËR BLERJEN E LIBRAVE TË BIBLIOTEKAVE TË INSTITUCIONEVE
ARSIMORE PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin e arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 9380, datë 28.4.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me të”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Bordi i rekomandimit të literaturës artistike e lëndëve shoqërore dhe bordi i rekomandimit të literaturës shkencore e didaktike, në përshtatje me kurrikulën e niveleve arsimore, përzgjedhin literaturën:

a) nga literatura përkatëse e mëparshme;

b) nga ofertat e shtëpive botuese, pas shpalljes së kërkesës nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

2. Bordet i paraqesin për miratim Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dy listat e literaturës së parashikuar në pikën 1, shoqëruar me shpjegimet e përzgjedhjes.

3. Ministria e Arsimit dhe Shkencës i dërgon çdo drejtorie arsimore rajonale (DAR)/zyrë arsimore (ZA):

a) fondin e planifikuar në zërin “Shpenzime për krijim fondi biblioteke”, sipas formulës “nxënës të regjistruar në fillim të vitit shkollor”;

b) dy listat e literaturës të miratuara nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

4. DAR/ZA-ja përdor për bibliotekën e DAR/ZA-së 1 (një)% të fondit të përcaktuar në zërin “Shpenzime për krijim fondi biblioteke” për atë DAR/ZA.

5. DAR/ZA-ja përllogarit sipas formulës “nxënës të regjistruar në fillim të vitit shkollor” fondin për bibliotekën e çdo institucioni arsimor publik në juridiksionin e saj dhe njofton zyrtarisht çdo institucion arsimor për këtë fond.

6. Institucioni arsimor publik ka të drejtë të shpenzojë për punonjësit arsimorë të institucionit jo më shumë se 15% të fondit për bibliotekën e institucionit për libra profesionale dhe revistën “Mësuesi”.



Pjesa tjetër e fondit shpenzohet për literaturën për nxënësit.

7. Drejtori i institucionit arsimor publik dërgon në DAR/ZA kërkesën e institucionit për literaturën dhe numrin e kopjeve për çdo rast.

Kërkesa bazohet në:

- a) fondin vjetor të miratuar për institucionin;
- b) dy listat e literaturës;
- c) çmimet e librave;
- d) propozimet e mësuesve.

8. Mbi bazën e porosive të çdo institucioni arsimor për bibliotekën, DAR/ZA-ja blen literaturën sipas procedurave të prokurimit publik dhe pajis çdo institucion arsimor publik me literaturën e porositur nga institucioni.

Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Planifikimit Buxhetor dhe DAR/ZA-të.

Ky udhëzim hyn në fuqi pasi botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

UDHËZIM
Nr. 36, datë 13.8.2013

PËR PROCEDURAT PËR ARSIMIMIN E FËMIJËVE TË NGUJAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe nenit 17 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Fëmijët e moshës së detyrimit shkollor, që janë të ngjuar, kanë të drejtë të arsimohen në kushtet e tyre të veçanta.

2. DAR/ZA-të dhe drejtoritë e shkollave bashkëpunojnë me organet e qeverisjes vendore për të evidentuar fëmijët e ngjuar.

3. Mësimi me fëmijët e ngjuar zhvillohet tri herë në javë, me 10 orë në javë.

4. Plani mësimor dhe programet lëndore hartohen nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit, sipas kurrikulës së arsimit bazë publik dhe miratohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

5. Kur është e mundur, nxënësit grumbullohen në një nga mjediset familjare mësimore më të afërta dhe të mundshme ku ka fëmijë të ngjuar (më tutje “mjedise mësimore”).

6. Në çdo dy mjedise mësimore të arsimit të mesëm të ulët, që janë pranë njëra-tjetrës, jep mësim një mësues i lëndëve shoqërore dhe një mësues i lëndëve natyrore, duke u këmbyer, me qëllim që të mbulohet mësimdhënia në këto dy fusha të nxëni.

7. Nxënësit e ngjuar u përkasin klasave të caktuara të shkollave publike të arsimit bazë.

Këto shkolla caktohen nga DAR/ZA-të përkatëse.

Mësuesit, që japin mësim në këto mjedise mësimore, janë në organikën e këtyre shkollave.

8. Procesi mësimor bazohet kryesisht te programet individuale, të cilat hartohen nga mësuesit përkatës, me porosi të drejtorit të shkollës.

9. Çdo mësues mban një fletore-regjistër dhe të dhënat e saj i hedh, një herë në dy javë, në regjistrin e klasës përkatëse të shkollës.

10. Pas përfundimit të vitit shkollor nxënësit pajisen me dëftesën e klasës përkatëse.

11. DAR/ZA-të sigurojnë shërbimin psiko-social për nxënësit e ngjuar.

12. Pagesa e orëve mësimore për mësuesit bëhet në përputhje me udhëzimin nr. 21, datë 23.7.2010 “Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar”.

13. Procesi mësimor me nxënësit e ngujuar është objekt i inspektimit nga Inspektorati Shtetëror i Arsimit, si dhe i monitorimit nga DAR/ZA-të përkatëse.

Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe DAR/ZA-të.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

UDHËZIM
Nr. 37, datë 13.8.2013

**PËR KRITERET DHE PROCEDURAT PËR PËRZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË
KËSHILLIT VENDOR TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 2 të nenit 31 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin e arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

KREU 1
KËSHILLI VENDOR I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

1. Këshilli vendor i arsimit parauniversitar është organ këshillimor, në nivel qarku, për politikat e zhvillimit të arsimit parauniversitar, brenda juridiksionit territorial të qarkut.
2. Këshilli vendor i arsimit parauniversitar më tutje “KVA” jep mendime:
 - a) për hartimin e strategjive dhe programeve arsimore vendore;
 - b) për aspekte të zhvillimeve arsimore në nivel qarku, bashkie e komune, që janë nën përgjegjësinë e tyre;
 - c) për bashkëpunimin me njësitë arsimore vendore përkatëse (Drejtoria Arsimore Rajonale/Zyra Arsimore) (DAR/ZA);
 - d) për çështje të tjera të politikave arsimore, me kërkesën e kryetarit dhe anëtarëve të KVA-së.
3. KVA krijohet me vendim të kryetarit të këshillit të qarkut dhe funksionon sipas rregullores së miratuar prej tij.
4. KVA kryesohet nga kryetari i këshillit të qarkut dhe ka në përbërje:
 - a) përfaqësues nga njësitë bazë të qeverisjes vendore përkatëse;
 - b) përfaqësues nga njësitë përkatëse arsimore vendore;
 - c) personalitete të njohura për kontribute në jetën publike të qarkut.
5. Numri i përgjithshëm i anëtarëve të KVA-së dhe i personaliteteve për kontribute në jetën publike vendoset nga këshilli i qarkut, duke qenë jo më shumë se 13 vetë.



KREU 2 KRITERET DHE PROCEDURAT

1. Pjesëmarrja në KVA organizohet sipas këtyre kriterëve:
 - a) një përfaqësues nga çdo bashki;
 - b) nga një përfaqësues në dy komunat me numrin më të madh të nxënësve në institucionet arsimore në juridiksion (kopsht, shkolla);
 - c) një përfaqësues nga DAR dhe çdo ZA.
2. Procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të KVA-së janë si më poshtë:
 - a) nga bashkia dhe komuna e përzgjedhur është anëtar kryetari i saj ose një punonjës i caktuar prej tij;
 - b) nga DAR dhe ZA-të marrin pjesë titullarët e tyre.
3. Anëtarët e KVA-së, të cilët janë personalitete të njohura për kontribute në jetën publike të qarkut;
 - a) i nënshtrohen konkurrimit publik;
 - b) përzgjidhen nga një komision, i ngritur pranë kryetarit të qarkut, i përbërë nga një përfaqësues i qarkut, një përfaqësues i bashkisë më të madhe dhe një përfaqësues i DAR-së.

KREU 3 RREGULLORJA E KVA-së

1. Rregullorja e KVA-së, përshkruan veprimtarinë e tij dhe miratohet në mbledhjen e parë të saj.
2. Rregullorja bazohet në rregulloren e Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar dhe përshtatet në kushtet specifike të qarkut.

Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe drejtoritë arsimore rajonale/zyrat arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pasi botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

UDHËZIM Nr. 38, datë 13.8.2013

PËR ARSIMIMIN E INDIVIDËVE TË MOSHËS SHKOLLORE NË INSTITUCIONET E PËRKUJDESJES SHOQËRORE

Në mbështetje të nenit 57 dhe 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 18 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”,

UDHËZIJMË:

1. Individët, nën kujdesin e institucioneve të përkujdesjes shoqërore, arsimohen me kohë të plotë ose të pjesshme në shkollën më të afërt me institucionin përkujdesës ose në një shkollë të arsimit publik të caktuar nga DAR/ZA-ja përkatëse.
2. DAR/ZA-ja, në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social, identifikon fëmijët që janë përfitues të shërbimeve të institucioneve të përkujdesjes shoqërore.

3. Çdo institucion i përkujdesjes shoqërore, publik ose privat, është i detyruar të njoftojë DAR/ZA-në përkatëse për çdo përfitues të shërbimeve shoqërore që nuk ndjek arsimin e detyrueshëm dhe t'i përcjellë të dhënat e mëposhtme:

- a) emrin, mbiemrin e përfituesit;
- b) emrin dhe vendndodhjen e institucionit të përkujdesjes shoqërore;
- c) adresën e banesës së përfituesit.

4. Kur përfituesi i përkujdesjes shoqërore është në moshën e detyrimit shkollor, DAR/ZA-ja cakton shkollën ku fëmija do të regjistrohet.

Regjistrimi mund të bëhet në çdo kohë.

5. Një komision i ngritur nga drejtori i shkollës, përcakton klasën që fëmija duhet të ndjekë.

6. Kur përfituesi i përkujdesjes shoqërore nuk është në moshën e detyrimit shkollor, institucioni përkatës i përkujdesjes shoqërore dhe DAR/ZA-ja, bashkëpunojnë për ta regjistruar përfituesin në një shkollë të arsimit bazë me kohë të pjesshme.

7. Kur përfituesi e ndërpret ndjekjen e një klase, pajiset nga shkolla me një dëftesë të veçantë ku shënohen notat lëndore të klasës në vijim.

Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

UDHËZIM
Nr. 5, datë 7.8.2013

**MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 31, DATË 20.1.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I INVALIDIT, PARAPLEGJIK DHE
TETRAPLEGJIK”, TË NDRYSHUAR**

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, në zbatim të pikës 8 të vendimit nr. 31, datë 20.1.2001 të Këshillit të Ministrave “Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të përcaktuar në pikën 4 të vendimit nr. 31, datë 20.1.2001 të Këshillit të Ministrave, është 9.750 (nëntë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë në muaj.

2. Masa e përfitimit për kujdestarin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, të përcaktuar në pikën 4 të vendimit nr. 31, datë 20.1.2001 të Këshillit të Ministrave, është 10.250 (dhjetë mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë në muaj.

3. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2013 dhe përballohen me fondet e akorduara për vitin 2013 për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në programin “Mbrotjtja sociale”, tit. 10 430, kap. 1, art. 606.

4. Udhëzimi nr. 9, datë 16.10.2012 i Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, shfuqizohet.



Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga 1.9.2013.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Spiro Ksera

UDHËZIM
Nr. 6, datë 7.8.2013

**MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 618, DATË 7.9.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË DOKUMENTACIONIT DHE MASËS SË
PËRFITIMIT TË PAGESËS PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR”, TË
NDRYSHUAR**

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, në zbatim të pikës 27 të vendimit nr. 618, datë 7.9.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr. 618, datë 7.9.2006 të Këshillit të Ministrave është 9.750 (nëntë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 1 të vendimit. Të njëjtën masë përfiton edhe kujdestari i personit me aftësi të kufizuar.

2. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr. 618, datë 7.9.2006 të Këshillit të Ministrave është 9.750 (nëntë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2 të vendimit dhe 10.250 (dhjetë mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë në muaj për kujdestari.

3. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2013 dhe përballohen me fondet e akorduara për vitin 2013 për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në programin “Mbrotjtja sociale”, tit. 10 430, kap. 1, art. 606.

4. Udhëzimi nr. 7, datë 20.9.2012 i Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga 1.9.2013.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Spiro Ksera

UDHËZIM
Nr. 7, datë 7.8.2013

**MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 277, DATË 18.6.1997 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I TË VERBRIT”, TË NDRYSHUAR**

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, në zbatim të pikës 16 të vendimit nr. 277, datë 18.6.1997 të Këshillit të Ministrave “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit për shkak të verbërisë, të përcaktuar në pikën 4 të vendimit nr. 277, datë 18.6.1997 të Këshillit të Ministrave, është 11.100 (njëmbëdhjetë mijë e njëqind) lekë në muaj. Të njëjtën masë përfiton edhe kujdestari i të verbrit.

2. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2013 dhe përballohen me fondet e akorduara për vitin 2013 për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në programin “Mbrotjtja sociale”, tit. 10 430, kap. 1, art. 606.

3. Udhëzimi nr. 8, datë 20.9.2012 i Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga 1.9.2013.

**MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Spiro Ksera**

**UDHËZIM
Nr. 425, datë 9.8.2013**

**PËR PROCEDURAT E HARTIMIT TË LISTAVE TË ZGJEDHËSVE PËR ZGJEDHJET E
PJESSHME TË PARAKOHSHME PËR KRYETAR TË KOMUNËS DARDHAS DHE
RRETHINA**

Në zbatim të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 49, 50, 59 të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të dekretit nr. 8280, datë 31.7.2013 të Presidentit të Republikës “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për kryetar të komunës Dardhas, qarku Korçë” dhe të dekretit nr. 8283, datë 2.8.2013 “Për përcaktimin e datës së zgjedhjeve për kryetar të komunës Rrethina, qarku Shkodër”, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme,

UDHËZOJ:

1. Ekstraktet e përbërësve zgjedhorë dhe listat e zgjedhësve gjenerohen automatikisht në afatet që parashikon ligji nga RKGJC-ja dhe janë të vlefshme në ndërfaqen grafike *online* të RKGJC-së. Procedura e gjenerimit të ekstrakteve dhe listave të zgjedhësve është funksionaliteti i sistemit të RKGJC-së, ku përgjegjësi i ZGJC-së shkarkon nga RKGJC-ja përbërësit zgjedhorë për zgjedhësit që i përkasin kësaj ZGJC-je si më poshtë:

te menuja në të majtë zgjedh opsionin “Procesi i regjistrimit”, “Raportime” dhe zgjedh listën.

2. Brenda datës 12 gusht 2013, RKGJC-ja gjeneron formatin elektronik të ekstraktit të përbërësve zgjedhorë të zgjedhjeve të 23.6.2013, të ndarë sipas qendrave të votimit, duke shtuar dhe të gjithë shtetasit me vendbanim në komunë, të cilët më datë 1.9.2013 mbushin moshën 18 vjeç.

3. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile kontrollon menjëherë raportin ditor për numrin e zgjedhësve për çdo qendër votimi. Kur vëren në raportin ditor të datës 12.8.2013 se ka qendra votimi me më pak se 200 zgjedhës, apo qendra votimi me më shumë se 1000 zgjedhës njofton brenda ditës kryetarin e komunës. Këto lista gjenden në formatin e posaçëm, kanë të shkruar në sfond “jo për afishim” dhe mund të përdoren vetëm për ndarjen, apo bashkimin e qendrave të votimit sipas ligjit, por në asnjë rast nuk mund të përdoren për afishim, apo në faza të tjera të



procesit zgjedhor. Gjithashtu, në format të posaçëm është edhe lista e zgjedhësve mbi 100-vjeçarë në datën e zgjedhjeve. Kjo listë i njoftohet kryetarit të komunës për të bërë njoftimin e këtyre shtetasve për arsyen e mospasqyrimin në listë. Në format të posaçëm është edhe lista e zgjedhësve që e kanë numrin e qendrës së votimit të ndryshëm nga qendrat e votimit që i përkasin kësaj zyre të gjendjes civile.

4. Lista e zgjedhësve është e grupuar sipas zonave të qendrave të votimit. Kufijtë e zonave të qendrave të votimit janë ato të zgjedhjeve të fundit. Kryetari, i cili ka marrë njoftimin nga nëpunësi i zyrës së gjendjes civile, vendos bashkimin dhe/ose ndarjen e qendrave të votimit sipas kërkesave të kriterit numerik dhe cakton vendndodhjen e saktë, adresën e plotë të qendrave të votimit.

5. Në rastet e qendrave të votimit me fraksion që kalojnë limitin numerik të përcaktuar në ligj, kryetari vendos ndarjen e tyre duke u nisur nga numri i përgjithshëm i zgjedhësve të qendrës së votimit bazë dhe jo çdo fraksion veç e veç. Numri i përgjithshëm i një qendre votimi me gjithë fraksionet e saj, do të ndahet në pjesë të barabarta me jo më shumë se 1000 zgjedhës.

6. Për qendrat e votimit me më pak se 200 zgjedhës kryetari vendos bashkimin e kësaj qendre me qendrën më të afërt me mundësi komunikimi rrugor e me më shumë se 200 zgjedhës. Nëse shuma e numrit të zgjedhësve për qendrat që do të bashkohen është më shumë se 1000 zgjedhës, atëherë kryetari pas bashkimit të këtyre qendrave vendos ndarjen me fraksion të tyre. Nëse dy a më shumë qendra votimi kanë më pak se 200 zgjedhës, qendra/qendrat me numër më të vogël i bashkohen qendrës me numër më të madh zgjedhësish.

7. Vendimet e kryetarit për ndarjen ose bashkimin e qendrave të votimit, si dhe ndryshimet e adresave të qendrave të votimit, nëse ka të tilla, do t'i dërgohen në formë shkresore zyrës së gjendjes civile për zbatim dhe Ministrisë së Brendshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile për dijeni, jo më vonë se 2 ditë nga marrja e informacionit nga zyra e gjendjes civile.

8. Përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile me marrjen e vendimit të kryetarit për ndarjen e qendrave të votimit kryen veprimet e mëposhtme: në menunë majtas zgjedh <administrimi i qendrave të votimit>, zgjedh numrin e qendrës së votimit që do të ndahet, plotëson fushën e përshkrimit me shënimin “Sipas vendimit nr. ____, datë __. __. 2013 të Kryetarit”, shtyp butonin <Ruaj>. Ky informacion mund të ndryshohet deri në orën 24:00 të asaj dite. Në rast mosndryshimi sistemi i RKGJC-së ekzekuton automatikisht kërkesën për ndarjen e qendrës së votimit sipas kriterit numerik dhe mbiemrit. Qendrat e votimit më fraksion marrin automatikisht adresën e qendrës bazë.

9. Përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile me marrjen e vendimit të kryetarit për bashkimin e dy a më shumë qendrave të votimit kryen veprimet si më poshtë: në menunë majtas zgjedh <administrimi i qendrave të votimit>, zgjedh numrin e qendrës së votimit që do të mbyllet, si dhe numrin e qendrës së votimit pritëse. Plotëson fushën e përshkrimit me shënimin “Sipas vendimit nr. ____, datë __. __. 2013 të Kryetarit”, shtyp butonin <Ruaj>. Ky informacion mund të ndryshohet deri në orën 24:00 të asaj dite. Në rast mosndryshimi sistemi i RKGJC-së ekzekuton automatikisht kërkesën për bashkimin e qendrave të votimit sipas vendimit të Kryetarit.

10. Në rast se Kryetari nuk përmbush detyrimet sipas pikës 4, 5, 6 dhe 7 të këtij udhëzimi deri në printimin e listës së datës 19 gusht 2013, DPGJC-ja kryen menjëherë ndarjen dhe/ose bashkimin e qendrave të votimit sipas kriterëve të përcaktuara në ligj, të cilat reflektohen në listat e zgjedhësve të datës 1 shtator 2013.

11. Kryetari i komunës brenda datës 16.8.2013 bën njoftimin me shkrim të zgjedhësve të përfshirë në ekstraktin e printuar sipas qendrave të votimit brenda territorit të komunës. Njoftimi për shtetasit do të jetë sipas modelit nr. 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi. Gjithashtu, brenda këtij afati, kryetari njofton edhe shtetasit me moshë mbi 100 vjeç për arsyen e mospërfshirjes së tyre në listë, sipas modelit nr. 2 bashkëlidhur.

12. Zgjedhësit, të cilët, kanë marrë njoftimin me shkrim nga ana e bashkisë/komunës dhe konstatojnë se në përbërësit e tyre zgjedhorë ka mospërputhje, i drejtohen zyrës së gjendjes civile përkatëse për të bërë rregullimet e mundshme.

13. Të drejtën për kërkesë e kanë edhe shtetasit që kanë mbushur moshën 100 vjeç. Këta shtetas do të bëjnë kërkesë për ndryshim të qendrës së votimit nga 8899 (qendër imagjinare e përdorur nga sistemi vetëm për këtë grup zgjedhësish) në qendrën e votimit sipas vendbanimit. Kjo kërkesë realizohet nëpërmjet formularit, sipas modelit nr. 3 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

14. Krahës ndryshimit të përbërësve zgjedhorë në rrugë administrative, zyra e gjendjes civile do të pasqyrojë edhe rastet e vendimeve të gjykatës, deri në ditën e printimit të listës së zgjedhësve.

15. Zyra e gjendjes civile në komunë më datë 19.8.2013 printon nga RKGJC-ja dhe firmos listën e zgjedhësve për çdo qendër votimi, nën juridiksionin territorial të saj dhe ia dorëzon Kryetarit.

DPGJC-ja publikon këtë listë në faqen e saj zyrtare.

16. Kryetari miraton dhe firmos listën dhe e dërgon brenda datës 20.8.2013 në të tria formatet e parashikuara në KZAZ-në përkatëse.

17. Një kopje e listës së zgjedhësve në format të printuar i dërgohet menjëherë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.

18. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, kryetari i komunës Dardhas dhe komunës Rrethina, si dhe nëpunësi i zyrës së gjendjes civile përkatëse dhe institucionet e tjera shtetërore që parashikohen në Kodin Zgjedhor.

19. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Flamur Noka

Modeli 1

QARKU: _____

DATA E ZGJEDHJEVE: 01.09.2013

Bashkia/ Komuna _____

Numri i banesës: _____

Ju njoftojmë se për Zgjedhjet pjesshme per kryetar komune, ju jeni të regjistruar në listën e qendrës së votimit numër , me adresë:

Z./Znj.	Resmije	Rama	Isuf	I datelindjes	24/04/1920	Nr ne liste:	24
Kryetari i Bashkisë/Komunës							
Firma: _____							

QARKU: _____

DATA E ZGJEDHJEVE: 01.09.2013

Bashkia/ Komuna _____

Numri i banesës: _____

Ju njoftojmë se për Zgjedhjet pjesshme per kryetar komune, ju jeni të regjistruar në listën e qendrës së votimit numër , me adresë:

Z./Znj.	Manjola	Lika	Gramos	I datelindjes	28/01/1988	Nr ne liste:	23
Kryetari i Bashkisë/Komunës							
Firma: _____							

QARKU: _____

DATA E ZGJEDHJEVE: 01.09.2013

Bashkia/ Komuna _____

Numri i banesës: _____

Ju njoftojmë se për Zgjedhjet pjesshme per kryetar komune, ju jeni të regjistruar në listën e qendrës së votimit numër , me adresë:

Z./Znj.	Shpëtim	Shehu	Myhedin	I datelindjes	26/11/1936	Nr ne liste:	25
Kryetari i Bashkisë/Komunës							
Firma: _____							



NJOFTIM

MODEL 2

DATA E ZGJEDHJEVE: 01/09/2013

QARKU: _____

Bashkia/Njësia bashkiake/Komuna: _____

Numri i banesës: _____

Z./Znj. _____

Ju njoftojmë se për Zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Komunës, sipas nenit 51 të Kodit Zgjedhor nuk jeni të përfshirë në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë të qendrave të votimit si shtetas që keni mbushur 100 vjeç. Sipas nenit 53 të Kodit Zgjedhor për tu përfshirë në listën e zgjedhësve, kërkesa e juaj duhet të bëhet pranë zyrës suaj të gjendjes civile.

KRYETARI

(Emër, Mbiemër, Firma)

MODEL 3

KËRKESË

Drejtuar: Bashkisë/Njesisë Bashkiake/Komunës : _____

Unë i quajtur _____ banor i Bashkisë/ Njesisë Bashkiake / Komunës
(emër, atësi, mbiemër)

_____ pasi mora njoftimin nga Kryetari se nuk jam i përfshirë në

listën e zgjedhësve, kërkoj nga ana juaj, të më shtoni në listën e zgjedhësve të qendrës së votimit

Nr _____ , aty ku janë të regjistruar dhe pjesëtarët e tjerë të familjes.

Emër, Mbiemër

(nënshkrimi)

Data: ____ / ____ / ____

UDHËZIM
Nr. 446, datë 12.8.2013

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 2, DATË 15.1.2013 “MBI PROCEDURAT E PRODHIMIT, KODIMIT, STAMPIMIT, SHPËRNDARJES DHE MONITORIMIT TË PULLAVE TË KONTROLLIT TË BARNAVE”

Në zbatim të ligjit nr. 10 381, datë 24.2.2011 “Për miratimin e kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Financave si autoritet kontratues dhe shoqërive “Sicpa Security Solutions S.A” e “Sicpa Security Solutions Albania sh.p.k.”, për projektimin, financimin, dizenjimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave”, si dhe pikës 9 të nenit 20 të ligjit nr. 9323, datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Ministri i Financave dhe Ministri i Shëndetësisë

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin nr. 2, datë 15.1.2013 “Mbi procedurat e prodhimit, kodimit, stampimit, shpërndarjes dhe monitorimit të pullave të kontrollit të barnave”, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 16.1 ndryshohet si më poshtë:

16.1 Për të gjitha subjektet farmaceutike zbatimi i udhëzimit do të fillojë 10 muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi. 10 muaj nga data e hyrjes në fuqi e këtij udhëzimi, nuk do të lejohen të importohen barna, si dhe nuk do të lejohen të hidhen në treg barna të prodhuara në vend pa pullën e vetme të kontrollit të barnave të prodhuar nga koncesionari.

2. Pika 16.2 ndryshohet si më poshtë:

16.2. Pas periudhës prej 10 muaj nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, inspektimet nga autoriteti në lidhje me zbatimin e këtij udhëzimi, do të kryhen në të gjithë territorin e vendit. Për shkeljen e dispozitave të këtij udhëzimi do të zbatohen sanksionet e përcaktuara në ligjin nr. 9323, datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik në RSH”, të ndryshuar.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

MINISTRI I SHËNDETËSISË
Halim Kosova

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 23.8.2013
Doli nga shtypi më 23.8.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 40 lekë